



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga Dëgjimi i përgjithshëm publik, mbajtur më 21.7.2026 i cili filloi në orën 14:00

Të pranishëm ishin: Valbona Makolli - drejtoreshë në Drejtorinë e Financave, drejtori i Drejtorisë së Arsimit - Arianit Elshani, shëfja e gjendjes civile - Shkëndije Krasniqi, drejtori i Drejtorisë së Sportit - Granit Geci.

Osman Bllaca: - hapi diskutimin e dytë për planifikimin e buxhetit për vitin 2027, duke theksuar se gjatë gjithë javës do të organizohen debate për të mbledhur kërkesat, komentet dhe argumentet e qytetarëve lidhur me problemet e komunitetit. Ai njoftoi se në takim ishin të pranishëm drejtori i Drejtorisë së Arsimit - Arianit Elshani, drejtoresha e Drejtorisë së Financave - Valbona Makolli, dhe shëfja e gjendjes civile - Shkëndije Krasniqi. Edhe pse fokusi kryesor i debatit ishte Drejtoria e Arsimit, qytetarët u ftuan të paraqesin edhe kërkesa tjera. Për shkak të numrit të vogël të pjesëmarrësve, diskutimi filloi menjëherë me prezantimin e pjesëmarrësve dhe paraqitjen e komenteve, me një kohë orientuese prej pesë minutash për secilin.

Fatmir Zhdrella, drejtor i shkollës “Teuta”: përshëndeti të pranishmit dhe shprehu keqardhje për numrin e vogël të pjesëmarrësve në debat. Ai theksoi bashkëpunimin e vazhdueshëm me Drejtorinë e Arsimit dhe Drejtorinë e Financave, duke nënvizuar rëndësinë e diskutimeve për zhvillimin e qytetit. Zhdrella tha se kishte ardhur për të dëgjuar planet për buxhetin e vitit të ardhshëm dhe shprehu pritjen që buxheti për arsimin të rritet, pasi kjo ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e arsimit dhe të qytetarëve. Në fund, ai shprehu habinë për mungesën e interesimit të qytetarëve për një debat që lidhet me sistemin arsimor.

Enver Redenica, asamblist: - ngriti shqetësimin për mungesën e veprimeve nga Komuna e Prishtinës lidhur me ndërtimin e çerdheve të reja, duke theksuar se investimet do të financohen nga Qeveria e Kosovës dhe nuk do ta rëndojnë buxhetin komunal. Ai tha se prej vitesh ka dorëzuar kërkesa për ndërtimin e dy çerdheve, një në “Sofali” dhe një në “Rrugën e Bledit”, por nuk ka marrë asnjë përgjigje. Sipas tij, ekziston toka publike dhe nevojitet vetëm

caktimi i lokacionit dhe procedimi i dokumentacionit nga komuna. Redenica i bëri thirrje Drejtorisë së Arsimit që ta shqyrtojë dhe procedojë kërkesën, duke kërkuar që interesat politike të mos pengojnë realizimin e projekteve në dobi të fëmijëve dhe komunitetit.

Isa Rexha, kryetar i Këshillit Lokal të Barilevës dhe Drenocit: - kërkoj sqarime lidhur me ndërtimin e çerdhes në Barilevë, duke theksuar se projekti ishte paraparë në buxhetin e këtij viti. Ai pyeti nëse çerdhja do të ndërtohet dhe, nëse jo, kërkoj të dijë arsyet. Rexha njoftoi se kërkesat i ka dorëzuar përmes arkivit dhe me email aty ku ka pasur kontaktet përkatëse. Gjithashtu, ai përmendi kërkesën për ndërtimin e një parkingu pranë shkollës, në një hapësirë ekzistuese. Në fund, ai kërkoj sqarim se si është e mundur që një projekt i buxhetuar të mos realizohet ose të tërhiqet nga planifikimi.

Drita Sulejmani, përfaqësuese e Rrjetit të Grave të Kosovës: - paraqiti rekomandimet e organizatës për planifikimin e buxhetit, të bazuara në analiza të realizuara gjatë dy viteve të fundit. Ajo kërkoj rritjen e investimeve në ndërtimin e çerdheve, duke theksuar se kjo do të lehtësonte barrën e kujdesit që rëndon kryesisht mbi gratë dhe do të kontribuonte në barazinë gjinore dhe pjesëmarrjen e tyre në tregun e punës. Gjithashtu, ajo propozoi shtimin e numrit të psikologëve në shkolla për trajtimin e dhunës me bazë gjinore, bullizmit dhe dhunës kibernetike, si dhe rritjen e numrit të asistentëve për fëmijët me nevoja të veçanta, duke theksuar se kjo është një nevojë e evidentuar nga ankesat e qytetarëve. Sulejmani rekomandoi gjithashtu buxhetimin e pecetave higjienike në shkolla për nxënëset dhe stafin, duke e përmendur Komunën e Obiliqit si shembull të mirë, si dhe shtimin e trajnimeve për mësimdhënësit në trajtimin e temave të ndjeshme në lëndë si biologjia dhe edukata qytetare. Në përfundim, ajo kërkoj zbatimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, duke theksuar se planifikimi i buxhetit duhet të bazohet në nevojat e të gjithë qytetarëve, pa dallim gjinie.

Deli Avdiu, kryetar i Këshillit të Lagjes Çagllavicë 2: - deklaroi se që nga viti 2012 ka përfaqësuar qytetarët e kësaj zone dhe gjatë gjithë kësaj periudhe ka adresuar vazhdimisht kërkesa në Komunën e Prishtinës dhe në Ministrinë e Arsimit për ndërtimin e institucioneve arsimore. Ai theksoi se, megjithëse kërkesat janë protokolluar, institucionet nuk kanë kthyer përgjigje me shkrim dhe nuk kanë ndërmarrë veprime konkrete. Sipas tij, katër lagjet – “Çagllavicë 1”, “Çagllavicë 2”, “Prishtina e Re 1” dhe “Prishtina e Re 2” – me mbi 15 mijë banorë, nuk kanë asnjë çerdhe publike, shkollë fillore apo shkollë të mesme. Ai nënvizoi se kjo situatë ka detyruar nxënësit të ndjekin mësimin në zona të tjera, ndërsa kërkesat e vazhdueshme të qytetarëve për ndërtimin e shkollave kanë mbetur pa realizim. Gjithashtu vlerësoi se dy projektet e nisura për ndërtimin e shkollave nuk i përgjigjen nevojave të banorëve, pasi njëra është ndërtuar në një lokacion që ai e konsideron të papërshtatshëm, ndërsa tjetra ndodhet jashtë territorit të lagjeve që ai përfaqëson. Ai shtoi se komuna disponon parcela publike të përshtatshme për ndërtimin e objekteve arsimore, por ato nuk janë shfrytëzuar. Në përfundim, ai u bëri thirrje institucioneve komunale dhe qendrore që të ndërmarrin masa konkrete për ndërtimin e çerdheve, shkollave fillore dhe të mesme në këto lagje, duke theksuar se kërkesa e qytetarëve ka të bëjë me sigurimin e të drejtës për arsim dhe jo me interesa politike.

Gëzim Sveçla - asambleist: - shprehu shqetësim për pjesëmarrjen shumë të ulët të qytetarëve në dëgjimin publik për arsimin. Ngrihet dilema nëse mungesa e pjesëmarrjes vjen nga mungesa e informimit apo nga humbja e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve komunale. Sipas folësit, arsyeja kryesore është humbja e besimit. Kritikohet mungesa e kryetarit, nënkryetarëve dhe drejtorëve tjerë relevantë në dëgjimin publik, duke e cilësuar këtë si mungesë serioziteti ndaj çështjeve të arsimit. Gjithashtu kërkohet të bëhet e ditur sa shkolla dhe çerdhe planifikohen të ndërtohen gjatë vitit të ardhshëm. Vlerësohet se planifikimet buxhetore për arsimin janë të pamjaftueshme dhe nuk adresojnë nevojat reale, si dhe ngrihet shqetësimi për zbatimin jo të barabartë të mësimi tërëditor, pasi ai zhvillohet vetëm në disa shkolla. Tutje kërkoi që mësimi tërëditor të ofrohet në mënyrë të barabartë në të gjitha shkollat e kryeqytetit, si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale, duke theksuar se, nëse komuna nuk mund ta zbatojë këtë model në mënyrë të barabartë, atëherë duhet të rishqyrtohet zbatimi i tij për të shmangur pabarazinë ndërmjet nxënësve. Pastaj tha se investimet në infrastrukturën shkollore konsiderohen prioritet kryesor për mundësimin e mësimi tërëditor në të gjitha shkollat, ndërsa kërkohet informacion se sa kërkesa i janë dërguar nivelit qendror për ndërtimin e çerdheve në territorin e kryeqytetit, duke pasur parasysh politikat dhe zotimet e qeverisë për zgjerimin e rrjetit të çerdheve.

Enver Redenica – asambleist: - shprehu shqetësim për sigurinë e nxënësve në afërsi të shkollës private “**Princeton**”, për shkak të problemeve të vazhdueshme në komunikacion. Ai theksoi se para dhënies së lejeve për funksionimin e shkollave private duhet të vlerësohen kushtet për sigurinë e fëmijëve dhe infrastruktura përreth. Tutje tha se ka bërë vazhdimisht kërkesa për vendosjen e masave që do të mundësonin lëvizje më të sigurt për nxënësit dhe banorët e zonës, duke nënvizuar evidentimin e bllokimit të rrugëve nga automjetet që rrezikon sigurinë e fëmijëve dhe pengon lëvizjen e lirë të banorëve. Pastaj tha se policia është njoftuar disa herë dhe ka ndërhyrë në raste të caktuara për menaxhimin e komunikacionit dhe shqiptimin e gjobave, por problemi vazhdon. Tutje kërkoi që siguria e nxënësve të jetë kriter prioritar gjatë miratimit të lejeve për shkollat, përpara interesave materiale, si dhe ngriti shqetësim edhe për gjendjen e komunikacionit pranë shkollës “**Gjergj Fishta**”, ku në oraret e hyrjes dhe daljes së nxënësve krijohen bllokime të mëdha, kërkohet nga institucionet përgjegjëse të vendosin mekanizma efektivë për menaxhimin e komunikacionit dhe garantimin e lëvizjes së sigurt të nxënësve dhe qytetarëve në afërsi të shkollave.

Arianit Elshani - drejtor në Drejtorinë e Arsimit: - falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen dhe kontributin në dëgjimin publik. Ai shprehu gatishtërinë për të dëgjuar dhe adresuar shqetësimet e qytetarëve lidhur me arsimin, duke theksuar se është i njohur me shumicën e problemeve të ngritura dhe i konsideron ato shqetësime të përbashkëta. Tutje vlerësoi se arsimi duhet të jetë një fushë që bashkon të gjithë, pa dallime politike, duke nënvizuar se interesi kryesor duhet të jetë mirëqenia e nxënësve dhe përmirësimi i kushteve në arsim. Pastaj ai theksoi se Prishtina ka nevojë për mbi 50 asistentë, si dhe për më shumë psikologë dhe logopedë në shkolla. Gjithashtu tha se familjet po përballen me pamundësinë për të paguar asistentë, prandaj nevojitet zgjidhje shtetërore, kurse shprehu shqetësim për mungesën e reagimit institucional ndaj kësaj çështjeje. Ai njoftoi se po përgatiten projekte për ndërtimin e një shkolle dhe një çerdheje me mbështetje të MASHT-it, si dhe shtoi se po identifikohen lokacionet për investime të reja, përfshirë edhe zonën e Çagllavicës. Theksoi se numri i

nxënësve në klasën e parë është kufizuar në 30, për të krijuar kushte për mësimin tërëditor. Sqaroi se janë eliminuar klasat me mbi 40 nxënës dhe është standardizuar regjistrimi. Vlerësoi se mësimi tërëditor nuk mund të funksionojë pa investime në infrastrukturë, kuzhina, kabinete dhe hapësira sportive. Tha se prioritet mbetet përmirësimi i kushteve në shkollat ekzistuese. Gjithashtu njoftoi se hapja e shkollave në Qëndresë, Kodrinë dhe Kalabri do të lehtësojë ngarkesën në shkollat e qendrës. Bëri të ditur se investimet kapitale në arsim do të rriten gradualisht deri në vitin 2029, si dhe tha se zgjerimi i rrjetit shkollor do të bëhet sipas rritjes së popullsisë dhe nevojave të qytetit, kurse sqaroi se Drejtoria e Arsimit nuk ka kompetenca për menaxhimin e shkollave dhe çerdheve private. Ai përfundoi se arsimi duhet të mbetet prioritet i përditshëm dhe të mbështetet me investime afatgjata.

Besa Shahini – asambleiste: - shprehu shqetësim për ritmin e ngadaltë të zgjerimit të kopshteve me bazë në komunitet. Tha se, përveç kufizimeve buxhetore, sfidë mbeten edhe hapësirat për ndërtimin e çerdheve në Prishtinë. Tutje theksoi se kopshtet me bazë në komunitet janë zgjidhje më ekonomike, pasi shfrytëzojnë hapësirat ekzistuese dhe vlerësoi se kostoja për komunën është shumë më e ulët sesa ndërtimi i objekteve të reja. Mandej sqaroi se prindërit kontribuojnë financiarisht, ndërsa investimi fillestar i komunës kufizohet kryesisht në mobilimin e hapësirave, kursr tha se në çdo lagje mund të gjendet një hapësirë e përshtatshme për një kopsht me bazë në komunitet. Në fund kërkoi sqarim pse ky model nuk po zgjerohet me një intensitet më të madh për të rritur përfshirjen e fëmijëve në edukimin e hershëm.

Enver Redenica – asambleist: - falënderoi drejtorin për përgjigjen, por tha se nuk mori përgjigje për çështjen e Bledit. Pyeti pse komuna nuk ka bërë deri më tani kërkesë te qeveria për financimin e çerdheve, duke qenë se ato subvencionohen. Ai kërkoi që komuna të rezervojë lokacione publike dhe t’ia përcjellë kërkesën qeverisë për ndërtimin e çerdheve, duke theksuar se ka tokë publike të mjaftueshme në Sofali dhe Bled, prandaj nuk duhet të rëndohen objektet ekzistuese të shkollave. Në fund pyeti se kush e ka pajisur me leje ndërtimi shkollën private “Princeton”, pasi u tha se Drejtoria e Arsimit nuk ka kompetenca për të.

Arianit Elshani - drejtor i Drejtorisë së Arsimit: - tha se buxhet ka e gjithashtu për Barilevë për me u ndërtu është i planifikuar lokacioni ku e ceku që buxhet ka edhe në KAB edhe për sivjet ka qenë kështu që buxhet ka vetëm lokacioni ka met me u dërgu prej neve për me u inicuar krejt procedura të tjera janë të planifikume.

Isa Rexha-qytetar nga Barileva: - tha se lokacioni për çerdhe në fshatin Barilevë ende s’është propozuar nuk ka as kanalizim, nuk ka as ndriçim. Po ashtu tha se unë para fshatarëve do të dal gënjeshtar dhe gjithashtu tha se ju kam drejtuar edhe kryetarit por e kot.

Arianit Elshani - drejtor i Drejtorisë së Arsimit: - e theksoi nevojën për investime në infrastrukturën shkollore, duke përfshirë korridoret, kuzhinat me ventilim, nyjet sanitare dhe kabinetet profesionale. Ai vlerësoi se mësimi duhet të kalojë nga teoria në praktikë përmes funksionalizimit të kabineteve. Gjithashtu, kërkoi përfshirjen e artistëve, sportistëve dhe organizatave të jashtme për zhvillimin e aktiviteteve jashtëkurikulare. Gjithashtu drejtori e nënvizoi rëndësinë e shfrytëzimit të oborreve dhe hapësirave të jashtme për mësim. Ai theksoi se mësimi tërëditor është ende në zhvillim dhe kërkon planifikim e mbështetje më të madhe. Në fushën e edukimit parashkollor, ai bëri të ditur se prioritet mbetet zgjerimi i rrjetit të

çerdheve në lagjet periferike. Po ashtu, drejtori e ka iniciuar hartimin e një rregulloreje për themelimin, menaxhimin dhe funksionalizimin e kopshteve me bazë në komunitet, me qëllim krijimin e një baze të qartë ligjore, transparencë në financim dhe menaxhim më efikas në shërbim të qytetarëve dhe fëmijëve.

Gëzim Sveçla – asambleist: - kërkoi që diskutimi për buxhetin të përqendrohet në projekte konkrete, me specifikim të investimeve, shkollave përfituese dhe mjeteve të planifikuara. Ai vlerësoi se prezantimi ishte tepër i përgjithshëm dhe nuk ofroi informacion të mjaftueshëm për planifikimin buxhetor. Gjithashtu asambleisti Sfeçla theksoi rëndësinë e vazhdimësisë institucionale dhe tha se kopshtet me bazë në komunitet funksionojnë prej vitesh mbi baza rregullative ekzistuese. Sipas tij, dokumentet ligjore duhet të përditësohen dhe plotësohen, jo të krijohen nga e para. Në fund, ai shprehu gatishmërinë për të mbështetur çdo projekt konkret në fushën e arsimit që sjell përmirësime për qytetarët.

Arianit Elshani – drejtor në Drejtorinë e Arsimit: - prezantoi projektet e planifikuara në buxhet, ku përfshihen renovimi i nyjeve sanitare me vlerë 250 mijë euro dhe ndërtimi i kampusit për shkollat e mesme me 150 mijë euro. Drejtori theksoi se gjendja e nyjeve sanitare në shumë shkolla është shqetësuese dhe kërkon investime më cilësore. Po ashtu, janë planifikuar investime për sistemet e sigurisë, alarmet, hyrje-daljet dhe pajisje sportive. Gjithashtu drejtori ngriti shqetësimin për mungesën e një databaze dhe inventarizimi të pajisjeve shkollore, gjë që ka sjellë shpërndarje jo të barabartë të investimeve mes shkollave. Ai njoftoi se synon krijimin e një sistemi transparent dhe të strukturuar, ku çdo kërkesë dhe investim të regjistrohet e të jetë publik. Sipas tij, kjo do të mundësojë planifikim më të drejtë dhe ndjekje të qartë të nevojave të secilës shkollë. Në diskutim u theksua gjithashtu se kërkesat e shkollës në Barilevë nuk janë përfshirë në buxhet për disa vite me radhë. Gjithashtu e ngriti edhe çështjen e mungesës së dokumentacionit të centralizuar në Drejtorinë e Arsimit dhe ka kërkuar sqarim lidhur me lejen e ndërtimit të shkollës “Princeton”, si dhe bashkëpunim për identifikimin e lokacioneve të reja për projekte arsimore.

Gëzim Sveçla – asambleist: - theksoi se identifikimi i nevojave për çerdhe dhe institucione arsimore është përgjegjësi e ekzekutivit, jo e qytetarëve. Ai tha se institucionet kanë të dhëna zyrtare për popullsinë dhe nevojat, prandaj iniciativa duhet të vijë nga komuna, kështu që vlerësoi se kërkesat e qytetarëve janë të rëndësishme, por nuk duhet të zëvendësojnë planifikimin institucional. Tutje shprehu se buxheti i Drejtorisë së Arsimit është në rritje, por mungojnë planet konkrete se ku do të investohen mjetet, si dhe kërkoi më shumë konkretizim për investimet në shkollat ku tashmë zbatohet mësimi tërëditor. Mandej pyeti se sa mjete do të investohen në shkolla konkrete, si “Zenel Hajdini”, si dhe sqaroi se çerdhja në Kolovicë ka nisur para rreth tre vjet e gjysmë dhe është vonuar për shkak të mungesës së lejes nga Drejtoria e Urbanizmit. Në fund theksoi se bashkëpunimi mes nivelit qendror dhe atij lokal nuk duhet të jetë pengesë për realizimin e investimeve në arsimin e kryeqytetit.

Isa Rexha, qytetar: - tha se nuk mori përgjigje të qartë për pyetjet e tij. Tutje kërkoi sqarim nëse çerdhja në Barilevë është ende e planifikuar apo është larguar nga buxheti, duke theksuar

se në buxhet është paraparë një investim prej 150.000 euro për çerdhen në Barilevë, ndërsa drejtori përmendi se një çerdhe kushton rreth 800.000 euro. Pastaj tha se që nga viti 2024 ka dorëzuar vazhdimisht kërkesa për Barilevën, të cilat i ka përsëritur edhe për buxhetet e viteve 2025, 2026 dhe 2027. Mandej shprehu pakënaqësi se, pavarësisht kërkesave, në Barilevë nuk po realizohen investime. Në fund theksoi se në zonë vazhdojnë të mungojnë investimet edhe në infrastrukturën rrugore, kurse kërkoi një përgjigje të qartë nga drejtori lidhur me fatin e projektit të çerdes në Barilevë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Dëgjimet publike lidhur me planifikimin e buxhetit për vitin 2027,
21.7.2026

Kryeqyteti - Prishtinë / Kuvendi Komunal

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
1	Deli	Avdha	K. Këshilltar		
2	Orta	Sylejmani	Kryetari Grupe të Kosovës		
3	FATMIR	ZHDREKA	DREKTOR - SHIFRA TEND		
4	BESMIR	BADONIQI	KCSF		
5	Enver	Redenica	Asamble		
6	Isa	Isa	K. K. Pr.		
7	GËZIM	SVECLA	K. K. Pr.		
8	BESA	SHAHINI	Keshilltar komunal		
9					
10					

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!
Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
11					
12					
13					
14					
15					
16					
17					
18					
19					
20					
21					
22					
23					
24					
25					
26					
27					
28					

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!
 Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
-----	-----------	-----------------	---------------	--------	----------------------

29					
30					
31					
32					
33					
34					
35					
36					
37					
38					
39					
40					
41					
42					
43					
44					
45					
46					

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!

Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!